




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority



Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, mbështetur në nenin 28, nenin 29, nenin 54, paragrafi (2) me nën paragrafin 2.3, neni 3 paragrafi (1.8), neni 34, neni 35 paragrafi (4, 5), i Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 ( Gazeta zyrtare nr.88/25 ), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, pas shqyrtimit të ankesave nga personat fizik, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datën 21.11.2019 merr këtë:

### KONKLUZION

- I. Pas shqyrtimit të situatës në tregun relevant vlerësojmë se ka një praktikë të bashkënduar në mes të pronarëve të ndërmarrjeve që transportojnë udhëtar nga Komuna e Lipjanit në Prishtinë dhe anasjelltas.
- II. Konstatojmë se këto veprime kanë ndikim jo të ndjeshëm mbi konkurrencën në tregun përkatës, duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 4 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- III. Autoritetit Kosovar i Konkurrencës do të vazhdojë edhe më tutje monitorimin dhe sjelljen e ndërmarrjeve në tregun përkatës në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- IV. Ky konkluzion hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni.

## ARSYETIM

---

1. Procedurën e konstatimit të marrëveshjeve të ndaluara nga neni 4 i këtij ligji, Autoriteti e fillon sipas iniciativës për fillimin e procedurës.
2. Autoritetit sipas ankesave të qytetarëve nga Komuna e Lipjanit, ka autorizuar inspektorët hetues që të monitorohet tregu relevant në këtë relacion, lidhur me dyshimin për marrëveshje të ndaluar në mes të pronarëve të ndërmarrjeve transportuese të udhëtarëve nga Lipjani në Prishtinë dhe anasjelltas.

### I. PROCEDURA E NDJEKUR NGA AUTORITETI

1. Autoriteti me dt. 18.09.2019 dhe dt. 09.10.2019 ka monitoruar tregun relevant në biseda me pronarë të ndërmarrjeve transportuese të udhëtarëve nga Lipjani.
2. Gjatë bisedës me pronarët e këtyre kompanive kemi konstatuar se ata kanë ngritur çmimet nga 0,50 euro në 0,70 euro e shprehur në përqindje afër 40% shtrenjtim i biletës së udhëtarëve për relacionin Lipjan-Prishtinë dhe anasjelltas. Ndërmarrjet transportuese të Komunës së Lipjanit me datë 24.08.2019 janë takuar në një mbledhje dhe kanë vendosur për themelimin e Shoqatës e transportierëve të Komunës së Lipjanit ndër të tjera ata kanë diskutuar për ngritjen e çmimit të biletave për relacionin relacionin Lipjan-Prishtinë dhe anasjelltas.
3. Më poshtë po paraqesim të dhëna në formë tabelore të mbledhura gjatë monitorimit të operatorëve që merren me transportin e udhëtarëve të Komunës së Lipjanit për linjën Lipjan-Prishtinë dhe anasjelltas.

Produkti	Çmimi para ngritjes	Çmimi pas ngritjes	Çmimi aktual
Biletë autobusi për linjën Lipjan – Prishtinë dhe anasjelltas	0,50 €	0,70 €	0,50 €

### II. PRETENDIMET E AUTORITETIT

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me datë 05.09.2019 ka pranuar ankesa nga persona fizik për shkak të dyshimit për marrëveshje të ndaluar ose praktikave të bashkërenduara në kuptim të nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 me që rast ka autorizuar inspektorët hetues për të monitoruar tregun relevant.

### III. PËRCAKTIMI I TREGUT RELEVANT

1. **Tregu gjeografik** - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës Nr. 02/2018, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Komunës së Lipjanit dhe Prishtinës.

2. **Tregu i produktit** - tregu i produktit konsiderohet bileta e ndërmarrjeve transportuese të udhëtarëve që udhëtojnë në linjën Lipjan – Prishtinë dhe anasjelltas.

## ANALIZA E KONKURENCËS

1. Për të analizuar rastin nga këndvështrimi i rregullave të Konkurrencës, Autoriteti ka trajtuar rastin në kuptim të nenit Nenin 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës “Marrëveshje të Ndaluar” për të vërtetuar nëse ka pasur fiksimit të çmimit me marrëveshje të shkruar apo në mënyrë të bashkërenduar.
2. Marrëveshjet e ndaluara në fiksimit të çmimit është një ndër shkeljet më të rënda dispozitave të ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.
3. Ndërmarrjet të cilat ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në transportimin e udhëtarëve në linjën Lipjan – Prishtinë dhe anasjelltas, pas konsultimeve me zyrtarët e AKK-së kanë *shfuqizuar marrëveshjen* dhe çmimet e biletave do të caktohen bazuar në ofertë dhe kërkesa në tregun përkatës. Pas shfuqizimit të kësaj marrëveshje ndërmarrjet kanë ri-kthyer çmimin në 0.50 cent për një biletë, në relacionin Lipjan – Prishtinë dhe anasjelltas.
4. Autoriteti konsideron se kjo marrëveshje nuk ka pasur ndonjë efekt të ndjeshëm në treg dhe konsiderohet si marrëveshje që nuk ka impaktë në treg e as palë të dëmtuar.

Këshilla Juridike:

*Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të inicioj konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.*

### KOMISIONI AUTORITETIT KOSOVAR I KONKURENCËS

  
Valton PRESTRESHI  
Kryetar

  
Ahmet KRASNIQI  
Zv. Kryetar

  
Fatime HAZIRI  
Anëtare

  
Muhamed KRASNIQI  
Anëtar

  
Shaqir MORINA  
Anëtar

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- Arhiva
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Pala ankuese
- Ndërmarrjeve